



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



*Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of
Internal Affairs*

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

PLANI VJETOR I PUNËS

AKSP-2025





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

Në mbështetje të nenit 14 paragrafit 1, nën-paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Plani Vjetor i Punës për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe Regjistri i Rrezikut për vitin 2025.
2. Obligohen të gjitha njësitë organizative të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për zbatimin e dokumenteve nga pika 1 e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vushtrri, më: 19.12.2024

Kastriot Jashari

Zëvendësuesi/Drejtori të
Përgjithshëm të AKSP-së

Vendimi iu dërgohet:

- Njësitë organizative të AKSP-së;
- Arkivit të AKSP-së.

TABELA E PËRMBAJTJES	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
DOKUMENTET E BAZUARA - REFERUESE	5
MISIONI DHE VIZIONI	6
VLERAT INSTITUCIONALE	6
OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET	7
ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	15
PLANI I VEPRIMIT I PLANIT VJETOR TË PUNËS AKSP - 2025.....	16



Akademia e Kosovës për Siguri Publike / AKSP është institucion i formuar me Ligjin Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (më tutje Akademia), përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.

Akademia ofron trajnime dhe arsim të lartë për të gjitha institucionet e sigurisë publike por pa u kufizuar vetëm në: Policinë e Kosovës; Shërbimin Korrektues; Shërbimin Sprovues; Doganën e Kosovës; Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe Inspektoratin Policor të Kosovës.

Duke pasur një mision të qartë, Akademia është e përkushtuar në arsimimin e zbatuesve të ligjit në mënyrë që të pajisë dhe avancojë njohuritë dhe shkathtësitë e duhura për të gjithë pjesëtarët e institucioneve të sigurisë publike që u shërbejnë qytetarëve të Republikës së Kosovës për të qenë të sigurt në ambientet ku jetojnë dhe veprojnë.

Plani i punës është dokument i cili për një vit orienton punën e secilës njësi brenda institucionit. Njëkohësisht përcakton kuadrin brenda institucionit të cilat duhet të angazhohen në aktivitetet përkatëse si dhe proceset që duhet zhvilluar dhe hapat e mëtutjeshëm deri në arritjen e rezultateve. Për përmbushjen e këtij plani AKSP do të angazhohet në menaxhimin e punës dhe bashkërendimin e aktiviteteve në mes programeve dhe shërbimeve tjera që ofron sipas ligjit si dhe në koordinimin me institucionet dhe përfituesit e saj sipas ligjit.

Sfidat përballuese me dukuritë negative kërkojnë që të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit të jenë fleksibile dhe në hap me kohën, andaj aktivitetet e AKSP-së janë të fokusuara në drejtim të ngritjes së kapaciteteve profesionale përmes ofrimit të arsimit të lartë dhe trajnimeve me qëllim të kryerjes së mandatit të saj ligjor.

Ky plan vjetor i AKSP-së përmban objektiva dhe aktivitetet e parapara që do të ndërmerren gjatë vitit 2025 duke i koordinuar ato me aspektet ligjore të mandatit të saj, prioritetet e Institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Institucioneve të Sigurisë Publike si hisedar të AKSP-së dhe Partnerëve tanë strategjik ndërkombëtar.



Qëllimi i këtij plani vjetor është që përveç detyrave / aktiviteteve rutinë të cilat janë të obliguar njësitë përkatëse t'i hartojnë e që rrjedhin nga akte të ndryshme normative ti përcakton edhe objektivat kryesore të cilët i ndërmerr AKSP-ja gjatë vitit 2025.

AKSP gjatë hartimit të Planit vjetor të punës është bazuar edhe në këto dokumente:

- Buxhetin vjetor të AKSP-së për vitin 2025;
- Planin e Përformancës së AKSP për vitin 2025;
- Prioritetet dhe direktivat e MPB;
- Planin Strategjik dhe Zhvillimor AKSP 2023-2026;
- Dokumentet strategjike që ndërlidhën me fushë veprimtarin e AKSP-së;
- Raportet e ekspertëve akreditues të AKK, AAK dhe IADLES;
- Marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara mes AKSP-së dhe Institucioneve vendore dhe ndërkombëtare;
- Raportet dhe rekomandimet e auditimeve dhe institucioneve tjera monitoruese.

Njësitë organizative të AKSP-së duhet që të hartojnë dhe zërthejnë aktivitetet e tyre në planet e njësisë mbi bazën e këtij plani institucional.

Po ashtu si ndërlidhje me aktivitetet e këtij plani janë edhe planet e njësive tjera të cilat sipas mandatit të tyre duhet ti hartojnë.

Duke qenë të vetëdijshëm se mund të ketë edhe zhvillime të reja, plani i punës është dokument që mund të evoluojë vazhdimisht.

Misioni

Misioni i Akademisë është të ofroj trajnim, arsimim dhe hulumtim me cilësi të lartë në fushën e sigurisë publike për të ndihmuar në ofrimin e ambientit të sigurtë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Vizioni

Akademia përmes ofrimit të trajnimeve dhe arsimimit me cilësi dhe standarde të ekselencës do të jetë faktor kyç në ngritjen e kapaciteteve të zbatuesve të ligjit konformë ndryshimeve dhe sfidave me të cilat përballën.

VLERAT INSTITUCIONALE



Akademia gjatë kryerjes së punëve dhe ndërmarrjes së veprimeve bazohet në këto vlera:

1) Ndershmëria – Nga secili anëtar i AKSP-së pritet të veprojë ndershmërisht në aspektin e punës dhe në jetën private. Kjo është më se e nevojshme dhe e domosdoshme për të bërë të mundshme dhe të realizueshme që AKSP të bëhet model i institucioneve publike. AKSP po ashtu në mënyrë të dukshme do të demonstrojë ndershmëri në proceset vendimmarrëse të saj.

2) Transparenca – Të gjitha proceset e AKSP-së: planifikimet, vendimmarrjet, vlerësimet, raportimet dhe të arriturat duhet të jenë tërësisht transparente për të gjithë palët e interesit në theks të strukturës, argumenteve dhe përgjegjësisë.

3) Përgjegjësi - AKSP fuqimisht demonstroi se do të mbajë përgjegjësi të plotë për nivelin e kompetencës së të diplomuarve. Brenda AKSP-së, secili anëtar i saj do të bartë dhe mbajë përgjegjësi për rezultatet të cilat rrjedhin nga veprimet dhe vendimet e tyre.

4) Etika profesionale – AKSP vë theksin mbi rëndësinë thelbësore në angazhimin e saj të të gjitha nivelet e arsimimit, te praktikat më të mira profesionale dhe vlerat organizative. AKSP si institucion do të jetë shembull në këtë aspekt.

5) Diversiteti – AKSP është e përkushtuar për të njohur, vlerësuar dhe respektuar ndryshimet e të tjerëve dhe kulturat e tyre si një mjedis që promovon dhe feston arritjet individuale dhe kolektive.

Plani vjetor i punës së Akademisë ka paraparë disa objektiva dhe aktivitete përmes të cilave synon të arrij rezultate të dukshme, të matura, të arritshme si vijon:

Objektivi strategjik 1 - Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të sigurisë publike përmes trajnimeve

Akademia për realizimin e fushëveprimit të saj si institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike ku në pajtueshmëri me objektivat e strategjisë synon avancimin dhe modernizimin e fushës së trajnimeve.

Plani i punës për vitin 2025 në kuadrin e trajnimeve do të përfshijë aktivitetet trajnuese që janë rezultati kërkesave nga Institucionet e sigurisë Publike/ISP, Partnerët Ndërkombëtar si dhe të gjitha dokumentet strategjike, prioritetet e MPB dhe nga vlerësimi i nevojave trajnuese që janë identifikuar nga takimet e përbashkëta me KFOR, Ambasada etj.

Të gjitha proceset e parapara në këtë fushë do të realizohen konformë standardeve të akreditimit vendor dhe ndërkombëtar si dhe praktikave me të mira të institucioneve relevante.

Arritja e rezultateve synohet të bëhet përmes ndërmarrjes së disa aktiviteteve si vijon:

AKTIVITETET

- 1.1. Analiza e nevojave për trajnim dhe hartimi i planit vjetor të trajnimeve në bashkëpunim me ISP-të dhe PN;
- 1.2. Implementimi i planit vjetor të trajnimeve;
- 1.3. Avancimi i ofrimit të trajnimeve digjitale;
- 1.4. Identifikimi dhe zhvillimi i trajnimeve të reja konformë nevojave të ISP-ve dhe dokumenteve strategjike;
- 1.5. Implementimi i Marrëveshjeve të Mirëkuptimit me Institucionet e Sigurisë Publike;
- 1.6. Rishikimi i objektivave të trajnimeve në përputhje me taksonominë e Bloomit.
- 1.7. Realizimi i projektit me USFS – SHBA për ofrimin e trajnimeve nga fusha Emerxhencave

Objektivi strategjik 2 - Qëndrueshmëria e arsimit të lartë në fushën e sigurisë

AKSP arsimin e lartë e sheh si një përcaktues shumë të rëndësishëm i ngritjes së kompetencave dhe kapaciteteve të institucioneve të sigurisë publike. Andaj me qëllim të përcjelljes së trendëve bashkëkohore në arsimimin e zyrtarëve të sigurisë konformë nevojave të institucioneve të sigurisë publike do të avancohen, krijohen programe studimore të cilat ndihmojnë ngritjen e kapaciteteve dhe sigurisë publike në vend.

Për arritjen e këtij objektive kërkohet angazhim dhe përkushtim i shumë akterëve (MPB, ISP, FSP, PN, AKA, etj) me qëllim të harmonizimit të nevojave të ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve të sigurisë publike përmes orientimit të dizajnit të programeve studimore.

Arritja e rezultateve synohet të bëhet përmes ndërmarrjes së disa aktiviteteve si vijon:

AKTIVITETET

- 2.1. Bashkërendimi i politikave rreth arsimit të lartë me akterët relevant (MPB, ISP, AKA, PN)
- 2.2. Vlerësimi, analizimi dhe rishikimi i programit studimor sipas kërkesave dhe nevojave të fushës së sigurisë publike;
- 2.3. Analizimi i rekomandimeve të sigurimit të jashtëm dhe të brendshëm të cilësisë;
- 2.4. Analizë e qëndrueshmërisë së numrit të studentëve të programeve studimore;
- 2.5. Rishikimi dhe ndryshimi i syllabuseve duke reflektuar çështjet e inovacionit në mësimdhënie dhe mësim nxënie;
- 2.6. Fuqizimi i kapaciteteve të personelit akademik përmes trajnimeve dhe vizitave studimore;
- 2.7. Rekrutimi dhe angazhimi i stafit akademik sipas nevojave arsimore;
- 2.8. Fuqizimi dhe promovimi i aktiviteteve me fokus studentin;
- 2.9. Analizimi dhe vlerësimi i nevojave për hartimin e dokumenteve relevante ligjore apo strategjike për administrimin e programeve studimore;

Objektivi 3: Zhvillimi i profilit hulumtues dhe projekteve në bashkëpunim me Institucionet e Sigurisë Publike

Veprimtaria kërkimore-shkencore është me interes të veçantë për Akademinë, qëllimi i së cilës është puna hulumtuese sistematike që bëhet për kërkimin dhe zhvillimin e njohurive të reja, shfrytëzimin dhe zbatimin e tyre në praktikë në sferën e sigurisë publike.

Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim do të jetë në shërbim të institucioneve të sigurisë publike duke zhvilluar aktivitete e tyre, si dhe duke krijuar inovacione të bazuara në nevojat që ato kanë. Projektet kërkimore do t'i plotësojnë kërkesat më të larta shkencore. Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim në Akademi do të fokusohet në fushën e krijimit të profilit hulumtues.

Arritja e rezultateve synohet të bëhet përmes ndërmarrjes së disa aktiviteteve si vijon:



AKTIVITETET

- 3.1. Organizimi i Konferencës, sesioneve dhe tryezave shkencore për tema me interes të Institucioneve të Sigurisë Publike;
- 3.2. Zgjerimi i rrjetit të hulumtimit përmes bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat hulumtuese;
- 3.3. Aplikim në projekte të përbashkëta për marrjen e fondeve ndërkombëtare
- 3.4. Hartimi i politikave për përcaktimin e veprimitarisë hulumtuese në shqyrtimin individual të performancës së mësimdhënësve;
- 3.5. Blerja e librave me interes në fushën e sigurisë publike;
- 3.6. Përcaktimi i politikave botuese dhe botimi i librave;
- 3.7. Planifikimi i kërkesave buxhetore për arritjen e planit të hulumtimit dhe miratimi i buxhetit adekuat të hulumtimit;
- 3.8. Përcaktimi i fushave me interes për hulumtime dhe bartësve të tyre;
- 3.9. Përgatitja dhe botimi i analizave rreth temave të sigurisë;
- 3.10. Realizimi i mobilitetit hulumtues në Institute Hulumtuese Ndërkombëtare;
- 3.11. Publikimi i artikujve shkencor në revistat e indeksuara sipas standardeve të AKA
- 3.12. Informimi i rregullt i stafit rreth ftesave për aplikim në grante, publikime, konferenca, seminare dhe punëtori me interes

Objektivi 4: Avancimi i sistemeve te menaxhimit te cilësisë sipas standardeve bashkëkohore në zbatimin e politikave te sigurimit te cilësisë dhe procesit te përmirësimit

Qëllimi këtij objektivi është që vazhdimisht nevojat trajnuese dhe arsimore të institucioneve të sigurisë publike të freskohen përmes ofrimit të kurrikulave trajnuese dhe programe studimore sipas kriterëve dhe standardeve të akreditimit vendore dhe ndërkombëtare. Andaj me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm dhe implementimin e standardeve dhe kërkesave të institucioneve të akreditimit dhe validimit nevojitet një dinamik e vazhdueshme e sigurimit të cilësisë.

Arritja e rezultateve synohet të bëhet përmes ndërmarrjes së disa aktiviteteve si vijon:



AKTIVITETET

- 4.1. Avancimi i sistemeve vlerësuese sipas sistemit Kirk-Patrick për programet trajnuese;
- 4.2. Rishikimi i politikave të sigurimit të cilësisë sipas standardeve bashkëkohore;
- 4.3. Zhvillimi dhe zbatimi i politikave përmirësuese;
- 4.4. Mbështetja e njësive organizative në zbatimin e politikave për sigurimin të cilësisë dhe procesit te përmirësimit;
- 4.5. Ri-akreditimi i AKSP si IAAP me trajnime profesionale te rivaliduara;
- 4.6. Ri-akreditimi i AKSP si IAL dhe Ri-akreditimi i programit studimor Bachelor;

Objektivi 5: Hartimi i dokumenteve të ndryshme normative, planifikuese, raportuese etj.

Përmes këtij objekti synojmë të krijojmë një mjedis pune motivues, i cili i shërben ndër të tjera rritjes profesionale të punonjësve, adoptimit të standardeve më të mira të institucioneve në këtë fushë, si dhe përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve administrative të institucionit. Hartimi i dokumenteve planifikuese rrit cilësinë dhe koordinimin e aktiviteteve të cilat synon ti ndërmerre institucioni. Po ashtu është paraparë hartimi i raporteve përmes të cilave prezantohen të arriturat, ngeçjet dhe sfidat e institucionit.

Arritja e rezultateve synohet të bëhet përmes ndërmarrjes së disa aktiviteteve si vijon:



AKTIVITETET

- 5.1. Ngritja e strukturës së përshtatshme organizative të AKSP-së
- 5.2. Hartimi i Planit të Përformancës 2026;
- 5.3. Hartimi i planeve periodike dhe vjetore të punës së AKSP-së;
- 5.4. Hartimi i Raporteve periodike dhe vjetore të AKSP sipas kërkesave dhe nevojave;
- 5.5. Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e dokumenteve planifikuese dhe strategjike.

Objektivi 6: Menaxhim efikas i burimeve njerëzore

Për ofrimin e shërbimeve efikase institucioni krijojmë standarde në përputhje me praktikat bashkëkohore, dhe si e tilli shfrytëzon kapacitetet e saja njerëzore dhe infrastrukture. AKSP-ja synon që të avancoj shërbimet e veta përmes ngritjes së kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukture.

Arritja e rezultateve synohet të bëhet përmes ndërmarrjes së disa aktiviteteve si vijon:



AKTIVITETET

- 6.1. Plotësimi i vendeve të lira sipas strukturës organizative;
- 6.2. Vlerësimi i nevojave për trajnimin e stafit;
- 6.3. Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të stafit;
- 6.4. Implementimi i ndryshimeve ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Objektivi 7: Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve të punës dhe infrastrukturës në AKSP

AKSP do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në përdorimin e teknologjisë informative për zbatim të programeve trajnuese, aktiviteteve dhe proceseve tjera të punës. Prandaj, avancimi, përmirësimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë informative do të vazhdojë të jetë ndër prioritetet e AKSP-së edhe për vitin 2025.

E veçantë për vitin 2025 do të jetë avancimi i njohurive në përdorimin e sistemit për avancimin e ligjërimit, blerjen e së paku një seti të zërimit si dhe përdorimin e ueb faqes me që ky sistem është zhvillim i ri dhe gjithsesi se ofron vegla të reja në menaxhim të dhënave në përgjithësi si dhe rritjen e sigurisë fizike përmes digjitalizimit të kontrolleve.



AKTIVITETET

Arritja e rezultateve synohet të bëhet përmes ndërmarrjes së disa aktiviteteve si vijon:

- 7.1. Zhvillimi i platformës së integruar softuerike për AKSP-së
- 7.2. Instalimi i pajisjeve të zërimit për nevoja trajnuese, ceremoniale etj;
- 7.3. Avancimi i ligjërimit përmes pajisjeve teknologjike – Smart Board;
- 7.4. Avancimi i shërbimeve të TI përmes rrjetave kompjuterike
- 7.5. Rritja e sigurisë fizike në hapësirat e AKSP-së përmes digjitalizimit të proceseve / kontrolleve
- 7.6. Funksionalizimi i qytetit simulativ

Objektivi 8: Infrastrukturë e përshtatshme për të siguruar mjedis cilësor për arsim dhe trajnim

Për ofrimin e shërbimeve efikase institucioni krijon standarde në përputhje me praktikën bashkëkohore, dhe si e tilli shfrytëzon kapacitetet e saja njerëzore dhe infrastrukturore. AKSP-ja synon që të avancojë shërbimet e veta përmes ngritjes së kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore.

Arritja e rezultateve synohet të bëhet përmes ndërmarrjes së disa aktiviteteve si vijon:

AKTIVITETET

- 8.1. Avancimi i infrastrukturës mësimore;
- 8.2. Furnizim me inventar të objektit të ri të Fakultetit;
- 8.3. Hartimi i planit për shpërndarjen adekuate të stafit në objektet e AKSP-së;
- 8.4. Marrja e masave për ambient dhe pajisje të sigurt që i plotësojnë kërkesat për shëndetin dhe sigurinë në punë;
- 8.5. Avancimi i mëtejshëm i sistemit arkivor;
- 8.6. Adresimi i rekomandimeve të auditorit të jashtëm dhe të brendshëm;
- 8.7. Renovimi i objekteve;
- 8.8. Vazhdimi i Implementimit të projektit kapital „Ndërtimi i objektit të ri të mensës së AKSP-së”

Objektivi 9: Fuqizimi i bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar si dhe rritja e kredibilitetit të AKSP

Akademia ka për qëllim të forcojë dhe më tutje bashkëpunimin vendor dhe ndërkombëtar, një bashkëpunim afatgjatë dhe të qëndrueshëm për të përkrahur objektivat e saj strategjike. Tashmë janë iniciuar dhe paraparë bashkëpunime me disa institucione relevante.

Po ashtu është e pritshme që bashkëpunimi të rezultojë në zhvillim të projekteve të përbashkëta të hulumtimit, shkëmbimin e informatave, organizimin e aktiviteteve të përbashkëta. AKSP-ja është e përkushtuar ta mbajë të informuar stafin, publikun, palët e interesit për të gjitha çështjet dhe aktivitetet që zhvillohen. Synimi i jonë për të avancuar mekanizmat e brendshëm për shpërndarjen e informacionit ka paraparë një mori aktivitete për të cilat ne do të përkushtohemi t'i realizojmë.

Arritja e rezultateve synohet të bëhet përmes ndërmarrjes së disa aktiviteteve si vijon:



AKTIVITETET

- 9.1. Identifikimi i partnerëve vendor dhe ndërkombëtar si dhe adresimi i kërkesave për mbështetje;
- 9.2. Nënshkrimi i marrëveshjeve vendore dhe ndërkombëtare;
- 9.3. Vazhdimi i bashkëpunimit me institucionet të cilat AKSP ka marrëveshje;
- 9.4. Identifikimi dhe shfrytëzimi i programeve të këmbimit (CEPOL, ERASMUS+, Fullbright etj);
- 9.5. Promovimi dhe inkurajimi i personelit dhe zyrtarëve të sigurisë publike për pjesëmarrje në programe të mobilitetit;
- 9.6. Përgatitja e broshurave, fletëpalosjeve dhe materialeve promovuese për punën e AKSP-së;
- 9.7. Organizimi i ngjarjeve të dukshmërisë dhe informimit me qëllim të promovimit të AKSP;
- 9.8. Përkrahja e aktiviteteve të OJQ-ve dhe komuniteteve të ndryshme rinore, sportive, kulturore vendore dhe ndërkombëtare.




AKSP është institucioni përgjegjës për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e përbushjes së Planit Vjetor të Punës.

ZBATIMI - Plani Vjetor i Punës së AKSP-së në përbërjen e saj ka edhe planin e veprimit i cili mbulon periudhën vjetore 2025 dhe përmban aktivitetet, treguesit, afatet, njësit përgjegjëse për zbatim si dhe koston financiare dhe dokumentet e ndërlidhura referuese të atyre aktiviteteve. Plani i veprimit të AKSP-së do të zërthehet në planet vjetore të njësisve dhe secila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të parapara me këtë plan.

MONITORIMI - Struktura për monitorimin e zbatimit të Planit Vjetor të AKSP-së përbëhet nga treguesit e matjes/rezultatet. Si tipare kryesore të monitorimit të zbatimit janë grumbullimi i të dhënave nga njësit përmes raporteve, takimeve zyrtare, etj., të cilat të dhëna përpunohen, analizohen dhe hartohen raporte në periudha të ndryshme kohore si mujore, tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujorë dhe vjetore. Monitorimi do të shërbejë për të ndjekur ecurinë e planit, pra për të matur në vazhdimësi shkallën e realizimit të objektivave të tij. Ky proces duhet të përfshijë tregues të qartë të progresit të bazuar në raportet periodike të njësisve si dhe të dokumenteve tjera relevante.

RAPORTIMI - Plani Vjetor i Punës do t'i nënshtrohet vlerësimit në periudha/kuartale të ndryshme kohore ku së paku çdo tre (3) muaj obligohen njësit të raportojnë. Mbi bazën e raporteve të pranuar analizohen veprimet dhe rezultatet ku hartohet raporti mbi progresin e arritur, ngecjet dhe sfidat e shfaqura sipas planit të veprimit.



PLANI I VEPRIMIT I PLANIT VJETOR TË PUNËS AKSP - 2025

OBJEKTIVAT	AKTIVITETET	AFATI	KOSTO FINANCIARE	TREGUESI I MATJES	Njësitë përgjegjëse/ Mbështetëse	Ndërlidhja me dokumente tjera	
1. Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të sigurisë publike përmes trajnimeve	1.1	Analiza e nevojave për trajnim dhe hartimi i planit vjetor të trajnimeve në bashkëpunim me ISP-të dhe PN	K1-K4	Kosto Administrative	- Analiza e hartuar - Plani vjetor i trajnimeve i miratuar	DTPA (ISP, PN)	Strategjia Zhvillimore e AKSP-së 2023-2026 - Plani i performancës së AKSP për vitin 2025 Standardet e akreditimit të AKK-së, IADLEST
	1.2	Implementimi i planit vjetor të trajnimeve	K1-K4	538,100.00 €	- Organizimi i trajnimeve sipas planit - Angazhimi i eksperteve të fushave përkatëse në trajnime - Rishikimi i planit vjetor të trajnimeve	DTPA	
	1.3	Avancimi i ofrimit të trajnimeve digjitale	K1-K4	Kosto administrative	Ofrimi i trajnimeve përmes sistemit digjital (e-trajnime, E-module, webinar)	DTPA, (ISP, PN)	
	1.4	Identifikimi dhe zhvillimi i trajnimeve të reja konformë nevojave të ISP-ve dhe dokumenteve strategjike	K1-K4	1,000.00 €	- Lista e nevojave e identifikuar dhe hartuar - Kurrikulat e trajnimeve të zhvilluara - Trajnimet e mbajtura sipas kërkesave	DTPA	
	1.5	Implementimi i Marrëveshjeve të Mirëkuptimit me Institucionet e Sigurisë Publike	K1-K4	Kosto Administrative	- Politika për vlerësimin e performancës së personelit trajnues e miratuar - Procedura për angazhimin e personelit trajnues e miratuar - Kriteret për ndarjen e trajnimeve mes AKSP dhe ISP-ve e miratuar	DTPA/ISP	
	1.6	Rishikimi i objektivave të trajnimeve në përputhje me taksonominë e Bloomit	K1-K4	Kosto Administrative	Trajnimet e rishikuara	DTPA/ DSCA,ISP	
	1.7	Realizimi i projektit me USFS-në e SHBA-së për ofrimin e Trajnimeve nga fusha e emergjencave	K1-k4	900€	Së paku 2 trajnime të realizuar në fushën e Emergjencave në bashkëpunim me projektin USFS-SHBA	DTPA/ISP	
2. Qëndrueshmëria e arsimit të lartë në fushën e sigurisë	2.1	Bashkërendimi i politikave rreth arsimit të lartë me akterët relevant (MPB, ISP, AKA, PN)	K1	Kosto administrative	- Politikat e harmonizuara me akterët	AKSP, FSP (MPB, ISP, AKA, PN)	- Strategjia Zhvillimore e AKSP-së 2023-2026
	2.2	Vlerësimi, analizimi dhe rishikimi i programit studimor sipas kërkesave dhe	K1-K2	Kosto Administrative	- Vlerësimi dhe analizimi i programit studimor; - Programi studimor i rishikuar;	FSP (ISP, PN)	

		nevojave të fushës së sigurisë publike dhe politikave të akorduara							-Plani i përfundimit të AKSP për vitin 2025
	2.3	Analizimi i rekomandimeve të sigurimit të jashtëm dhe të brendshëm të cilësisë	K1	Kosto Administrative	- Analiza e hartuar - Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve i hartuar - Zbatimi i rekomandimeve	FSP (të gjitha njësit)			
	2.4	Analizë e qëndrueshmërisë së numrit të studentëve të programeve studimore	K1-K2	Kosto administrative	- Analiza me rekomandimet konkrete e finalizuar; - Plani i veprimit i hartuar	FSP/ ISP,PN			
	2.5	Rishikimi dhe ndryshimi i syllabuseve duke reflektuar çështjet e inovacionit në mësimdhënie dhe mësim nxënie	K2-K4	Kosto administrative	- Syllabuset e rishikuara	FSP/ DSCA			
	2.6	Fuqizimi i kapaciteteve të personelit akademik përmes trajnimeve dhe vizitave studimore	K1-K4	E buxhetuar / Donacion	- Vlerësimi i nevojave për zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit akademik, mentorëve të intershipëve - Organizimi i trajnimeve - Organizimi i vizitave studimore në institucione vendore e ndërkombëtare	FSP (ZDP)			
	2.7	Rekrutimi dhe angazhimi i stafit akademik sipas nevojave arsimore	K1-K4	E buxhetuar	- Personeli akademik i rekrutuar për plotësimin e nevojave aktuale të programeve sipas standardeve të kërkuara të AKA - Hartimi i planit për angazhimin e personelit akademik në mësimdhënie	FSP/AKSP			
	2.8	Fuqizimi dhe promovimi i aktiviteteve me fokus studentin	K1-K4	Kosto administrative	- Fuqizimi Këshillit studentor - Organizimi i ditës orientuese - Organizimi i ceremonisë diplomimit - Përfshirja e studentëve në aktivitete shkencore	FSP/AKSP			
	2.9	Analizimi dhe vlerësimi i nevojave për hartimin e dokumenteve relevante ligjore apo strategjike për administrimin e programeve studimore	K1-K4	Kosto administrative	Analiza e Hartuar me rekomandime konkrete	FSP/ DPSCCL /DSC			
3. Zhvillimi i profilit hulumtues dhe	3.1	Organizimi i Konferencës, sesioneve dhe tryezave shkencore për tema me interes të Institucioneve të Sigurisë Publike	K1-K4	3,000.00 €	- Së paku 1 konferencë shkencore mbajtur - Së paku 2 sesione /tryeza të mbajtura - Publikimi i materialeve të konferencës dhe tryezave shkencore	FSP			Strategjia

projekteve në bashkëpunim me Institucionet e Sigurisë Publike	3.2	Zgjerimi i rrjetit të hulumtimit përmes bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat hulumtuese	K1-K4	2,000 €	<ul style="list-style-type: none"> - Dizajni dhe krijimi i platformës hulumtuese duke identifikuar dhe anëtarësuar hulumtues të rinj nga ISP - Blerja e programit softuerik SPSS dhe sigurimi i qasjes në programe statistikore online - Organizimi i trajnimit rreth zhvillimit të projekteve hulumtuese dhe përdorimit të programeve statistikore për anëtarët e rinj 	FSP	Zhvillimore e AKSP-së 2023-2026 Plani i performancës së AKSP për vitin 2025
	3.3	Aplikim në projekte të përbashkëta për marrjen e fondeve ndërkombëtare	K1-K4	Kosto administrative	Projektet e dorëzuara	IHZH /	
	3.4	Hartimi i politikave për përcaktimin e veprimtarisë hulumtuese në shqyrtimin individual të performancës së mësimdhënësve	K1-K4	Kosto administrative	Planet e Hartuara	FSP	
	3.5	Blerja e librave me interes në fushën e sigurisë publike	K1-K4	500 €	Së paku 5 tituj me 3 ekzemplar për secilin janë siguruar	FSP DFSHP	
	3.6	Përcaktimi i politikave botuese dhe botimi i librave	K1-K4	2000 € për botim	<ul style="list-style-type: none"> - Politika e përcaktuar - Librat e botuar 	FSP	
	3.7	Planifikimi i kërkesave buxhetore për arritjen e planit të hulumtimit dhe miratimi i buxhetit adekuat të hulumtimit	K1-K4	Kosto administrative	<ul style="list-style-type: none"> - Kërkesat buxhetore të identifikuar - Buxheti i përcaktuar 	IHZH(DBF)	
	3.8	Përcaktimi i fushave me interes për hulumtime dhe bartësve të tyre	K1-K4	Kosto Administrative	<ul style="list-style-type: none"> - Fushat e përcaktuara - Bartësit e përcaktuar - Studentët e përfshirë 	IHZH(FSP,DPS CL,ISP)	
	3.9	Përgatitja dhe botimi i analizave rreth temave të sigurisë	K1-K4	1.000 € për botim	- Analizat e botuara	IHZH/ FSP, DFSHP,ISP	
	3.10	Realizimi i mobilitetit hulumtues në Institute Hulumtuese Ndërkombëtare	K1-K4	E buxhetuar	- Mobilitetet e realizuara	IHZH	
	3.11	Publikimi i artikujve shkencor në revistat e indeksuara sipas standardeve të AKA	K1-K4	1.000 € për publikim	- Së paku 1 publikim në vit për mësimdhënës	IHZH (FSP)	
	3.12	Informimi i rregullt i stafit rreth ftesave për aplikim në grante, publikime, konferenca, seminare dhe punëtori me interes	K1-K4	Kosto administrative	- Njoftimet e shpërndara	IHZH(të gjitha njësitë)	

4. Avancimi i sistemeve te menaxhimit te cilësisë sipas standardeve bashkëkohore në zbatimin e politikave te sigurimit te cilësisë dhe procesit te përmirësimit	4.1	Avancimi i sistemeve vlerësuese sipas sistemit Kirk-Patrick për programet trajnuese	K1-K4	Kosto Administrative	- Politika e hartuar për implementimin e sistemit kirk-patric - Implementimi i sistemit	DSC (të gjitha njësitë)	Raportet e vlerësimit akreditues të AKK, AAK dhe IADLES Strategjia Zhvillimore e AKSP-së 2023-2026
	4.2	Rishikimi i politikave të sigurimit të cilësisë sipas standardeve bashkëkohore	K1-K4	Kosto Administrative	- Politikat e rishikuara në doracakun e cilësisë	DSC (të gjitha njësitë)	
	4.3	Zhvillimi dhe zbatimimi i politikave përmirësuese	K1-K4	Kosto Administrative	- Planet e veprimit të hartuara konformë analizave të raporteve	DSC (të gjitha njësitë)	
	4.4	Mbështetja e njësive organizative në zbatimin e politikave për sigurimin të cilësisë dhe procesit te përmirësimit	K1-K4	Kosto Administrative	Zhvillimi i takimeve për përmirësim	DSC (të gjitha njësitë)	
	4.5	Ri-akreditimi i AKSP si IAAP me trajnime profesionale te rivaliduara	K1-K4	10.000 €	- Standardet e profesionit të rishikuara - Aplikimi për aprovim të standardeve të profesionit pranë KAAPRr i MASHT-it dhe KD i AKK-së - Dokumentet e përgatitura për aplikim - Aplikacioni i dorëzuar - Programet e validuara dhe institucioni akredituar	DSC (DTPA, të gjitha njësitë)	
	4.6	Ri-akreditimi i AKSP si IAL dhe Ri-akreditimi i programit studimor Bachelor	K1-K4	20.000€	- Dokumentet mbështetëse të përgatitura për aplikim - Aplikacioni i dorëzuar	DSC / FSP, të gjitha njësitë	
5. Hartimi i dokumenteve të ndryshme normative, planifikuese, raportuese etj	5.1	Ngritja e strukturës së përshtatshme organizative të AKSP-së	K1-K4	Kosto administrative	Rregullorja e hartuar dhe proceduar në MPB për aprovim	DPSÇL (të gjitha njësitë)	Strategjia Zhvillimore e AKSP-së 2023-2026 Raportet dhe rekomandimet e institucioneve monitorues
	5.2	Hartimi i Planit të Përformancës	K3-K4	Kosto administrative	Plani i përformancës i miratuar	DPSÇL te gjitha njësitë	
	5.3	Hartimi i planeve periodike dhe vjetore të punës së AKSP-së	K1-K4	Kosto administrative	- Hartimi i planeve mujore për MPB - Hartimi i planit vjetor AKSP	DPSÇL / te gjitha njësitë	
	5.4	Hartimi i Raporteve periodike dhe vjetore të AKSP sipas kërkesave dhe nevojave	K1-K4	Kosto administrative	- Hartimi i raporteve periodike dhe vjetore të punës - Hartimi i raporteve sipas kërkesave të MPB	DPSÇL / te gjitha njësitë	
	5.5	Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e dokumenteve planifikuese	K1-K4	Kosto administrative	- Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e strategjisë zhvillimore të AKSP 2024 - Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e Planit të Përformancës	DPSÇL / te gjitha njësitë	

					- Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e Planit të Integritetit - Hartimi i raportit për pyetëtorin e vetëkontrollit financiar të NJQH-MFPT		
6. Menaxhim efikas i burimeve njerëzore,	6.1	Plotësimi i vendeve të lira sipas strukturës organizative	K1-K4	Kosto administrative	- Identifikimi i pozitave të lira - Hartimi i planit të rekrutimit - Shpallja e konkurseve sipas planit rekrutues	DBNJ/ të gjitha njësitë	Strategjia Zhvillimor e AKSP-së 2023-2026 Plani integriteti AKSP 2024-2026
	6.2	Vlerësimi i nevojave për trajnimin e stafit	K1-K4	Kosto administrative	- Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për trajnimin e stafit - Hartimi i Planit për ngritjen e kapaciteteve	DBNJ/ të gjitha njësitë	
	6.3	Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të stafit përmes trajnimeve	K1-K4	12.368.00€	- Trajnimi stafit sipas planit të trajnimeve - Implementimi i dokumenteve tjera për trajnim (Plani integritetit, strategjia AKSP, etj)	DBNJ/ të gjitha njësitë	
	6.4	Implementimi i ndryshimeve ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore	K1-K4	Kosto administrative	- Ndryshimet e implementura	DBNJ/ të gjitha njësitë	
7. Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve të punës dhe infrastrukturës në AKSP	7.1	Zhvillimi i platformës së integruar softuerike për AKSP-së	TM1	65.000 €	Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve dhe shërbimeve dhe integrimi i bazave aktuale të dhënave.	DFSHP/DTI	Strategjia Zhvillimore e AKSP-së 2023-2026 Plani Vjetor i Performancës AKSP 2025
	7.2	Instalimi i pajisjeve të zërimit për nevoja trajnuese, ceremoniale etj	TM2-TM4	20.000 €	Pajisjet funksionale për paradën e kadetëve, pajisjet për BLEEP TEST në sallën e sportit, pajisjet e zërimit në qendrën mësimore ST Bennet.	DFSHP/DTI	
	7.3	Avancimi i ligjërimit përmes pajisjeve teknologjike – Smart Board	TM2-TM4	50.000 €	Avancimi i ligjërimit nga niveli klasik në nivelin me smartboard dhe integrimi shërbimeve ligjëruese në një pajisje.	DFSHP/DTI	
	7.4	Avancimi i shërbimeve të TI përmes rrjetave kompjuterike	TM2-TM4	10.000 €	Avancimi i infrastrukturës së rrjetave kompjuterike duke instaluar pajisje të reja si Switch-a me PoE, Router-a, panele dhe switch-a optik, Servera etj.	DFSHP/DTI	
	7.5	Rritja e sigurisë fizike në hapësirat e AKSP-së përmes digjitalizimit të proceseve / kontrolleve	TM2-TM4	5.000 €	Avancimi i sigurisë fizike në AKSP përmes instalimit të rampave elektronike, brave elektronike etj.	DFSHP/DTI	
	7.6	Funksionalizimi i qytetit simulativ	TM2-TM4	10.000€	Funksionalizimi i Qytezës simulative për nevojat trajnuese (ushtrimeve operacionale- praktike)	DFSHP/DTI	

8. Infrastruktura e përshtatshme për të siguruar mjedis cilësor për arsim dhe trajnim	8.1	Avancimi i infrastrukturës mësimore	K1-K4	46.000 €	<ul style="list-style-type: none"> - Furnizimi me laboratorin për simulimin e krimeve kibernetike, pajisje për detektimin e parave dhe dokumenteve false etj. - Funkcionalizimi i dhomës së webinarit - Furnizimi dhe funksionalizimi i dhomës simulative për trajnimet nga fusha e hetimeve të krimit - Furnizimi me pajisje përcjellëse sinjalizuese dhe përkufizuese të hapësirës për trajnim - Pajisja e hapësirave trajnuese me shenjat dhe rregullat permanente. Funksionalizimi i poligonit për zjarr fikjes (për ushtrimet e profesionit zjarrfikës sipas kërkesës së AKK) 	DFSHP/DTPA	Raportet dhe rekomandimet e institucioneve monitoruese
	8.2	Furnizim me inventar të objektit të ri të Fakultetit	K1-K4	450.000.00	Inventarizimi i objektit FSP	DFSHP	
	8.3	Hartimi i planit për shpërndarjen adekuate të stafit në objektet e AKSP-së	K1-K4	Kosto administrative	Plani i hartuar	DFSHP (të gjitha njësitë)	
	8.4	Marrja e masave për ambient dhe pajisje të sigurt që i plotësojnë kërkesat për shëndetin dhe sigurinë në punë	K1-K4	Kosto administrative	- Plotësimi i kërkesave për sigurinë dhe shëndetin	DFSHP të gjitha njësitë	
	8.5	Avancimi i mëtejshëm i sistemit arkivor	K1-K4	1.000 euro	Sistemi arkivor funksional	DFSHP/ të gjitha njësitë	
	8.6	Adresimi i rekomandimeve të auditorit të jashtëm dhe të brendshëm	K1-K4	Kosto administrative	<ul style="list-style-type: none"> - Raportet e pranuar dhe adresuara - Rekomandimet e zbatuara 	Të gjitha njësitë	
	8.7	Renovimi i objekteve të AKSP	K1-K4	100.000.00€	- Objekteve të renovuara	DFSHP	
	8.8	Vazhdimi i Implementimi të projektit kapital Ndërtimi i objektit të ri të mensës së AKSP-së	K1-K4	467.285.00 €	<ul style="list-style-type: none"> - Procedura tenderuese dhe lidhja kontratës - Vazhdimi i punimeve 	DFSHP	
9. Fuqizimi i bashkëpunimit	9.1	Identifikimi i partnerëve vendor dhe ndërkombëtar si dhe adresimi i kërkesave për mbështetje	K1-K4	Kosto administrative	<ul style="list-style-type: none"> - Partnerët vendor dhe ndërkombëtar të identifikuar për mbështetje - Kërkesat e hartuara dhe adresuara 	DMJ (të gjitha njësitë)	Raportet e vlerësimit akreditues të

vendor dhe ndërkombëtar si dhe rritja e kredibilitetit të AKSP	9.2	Nënshkrimi i marrëveshjeve vendore dhe ndërkombëtare	K1-K4	Kosto administrative	Marrëveshjet e nënshkruara me institucionet e reja	DMJ (DPSÇL)	AKK, AAK dhe IADLES Direktivat e MPB
	9.3	Vazhdimi i bashkëpunimit me institucionet të cilat AKSP ka marrëveshje	K1-K4	Kosto administrative	Marrëveshjet e nënshkruar - vazhduar – Mali i Zi	DMJ (DPSÇL)	
	9.4	Identifikimi dhe shfrytëzimi i programeve të këmbimit (CEPOL, ERASMUS+, Fullbright etj,) dhe bashkëpunimi biletaral	K1-K4	Donacion	Aktivitetet e realizuara - CEPOL: Erasmus+, Fullbright: - Bashkëpunimi me NPUC, Norvegji (mobiliteti i studentëve) - Bashkëpunimi me FP, Lituaninë (mob.stu) USFS, SHBA	DMJ (AKSP, ISP)	
	9.5	Promovimi dhe inkurajimi i personelit dhe zyrtarëve të sigurisë publike për pjesëmarrje në programe të mobilitetit	K1-K4	Kosto administrative	- Materialet promovuese shpërndara - Aktivitetet e realizuara	DMJ / të gjitha njësitë	
	9.6	Përgatitja e broshurave, fletëpalosjeve dhe materialeve promovuese për punën e AKSP dhe promovimin e programit studimor	K1-K4	2.000 €	Broshurat, fletëpalosjet dhe materialet promovuese të përgatitura	MEDIA/të gjitha njësitë	
	9.7	Organizimi i ngjarjeve të dukshme dhe informimit me qëllim të promovimit të AKSP	K1-K4	Kosto administrative	Së paku 2 ngjarje të Organizuara /promovuara çdo vit	ZDP, DMJ	
	9.8	Përkrahja e aktiviteteve të OJQ-ve dhe komuniteteve të ndryshme rinore, sportive, kulturore vendore dhe ndërkombëtare	K1-K4	Kosto administrative	Aktivitetet e organizuara për komunitetet e ndryshme	DFSHP / DTPA	